


Vangel Leha

BIBLIOTEKA
SHTETIT



Pas
shëtërgatës
vjetës



Vangjel Leka, ka lindur
në Dhërmi të Vlorës më
1944.

Në vitin 1964 ai mba-
roi shkollën e oficerave
«Enver Hoxha» dhe shërbue
në radhët e ushtrisë popu-
llore si oficer aktiv. Ka
mbaruar fakultetin Histori-
-filologji (Dega e gjuhë-le-
tersisë shqipe). Punon në
Kino-studion «Shqipëria e
Re».

Ky është libri i tij i parë.

85H-1

L 45

VANGJEL LEKA

LIBRI I VANGJEL LEKËS

PAS SHTËRGATËS

Vjersha



13230

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

KUR TAKOJ ENVERIN

Kur takoj Enverin, lulëzon fantazia...
Shpirti i tij i madh është si gjerësia e detit,
që shpalos diçka të re, të bukur;
thellësia e tij është thellësia e detit.

Kur takoj Enverin, gjithshka më brohoret,
shoh vijën e largët, të kaltërt, ku puqet deti me
qiellin,
shoh perspektivën tonë të qartë si diellin.

S H Q E T È S I M

Në një natë si kjo plot shi e ftohtësirë,
nën retë e ngarkuara rëndë,
nën një gëzim që më bënte të mos e ndjeja kohën,
erdhi ky vit, që son te e përcjell i shqetësuar.

Si e humba pranverën gjurmëmadhe të këtij viti?
Si e humba verën duke thënë aq pak këngë për të
vërtetën.

Si e humba vjeshtën flokëkuqe?
Si e humba vitin,
pa thënë kush e transformoi reliefin.

Në një natë si kjo, plot shi e ftohtësirë,
kur në pragu tim hyri Viti i ri,

u thashë zjarrfikësave se s'kanë ç'tu bëjnë qiejve
që digjen,
njoftova ambulancën, se një grua po lindte vajzën
e Vtitit tē ri.

Kur gjithshka lind,
kur koha pret nga «ndjenjat tē nxjerrim gjak»,
për njerëzit dhe tokën,
shqetësohem, se humba pranverën duke thënë pak.

ISHIN KËNGËT

Një natë nuk gjeja qetësi;
u përflita me vete, ç'ishte kështu?
Në gjoksin tim buçiste deti,
dëgjoja gjëmime, kërcitje armësh, blegërime
qengjash,

duke u përplasur dhjetëra lumenj në trupin tim,
më digjnin rënjet e flokëve,
fërfërinin pyjet, kumbimet e sopatave rritheshin,
majat avullonin si sharqe çobenësh.

Ç'ishte kështu?
O jetë, nga rrënjet e tua
këputeshin e dilnin
minerale të rënda,
këngët.

DUKE KÉRKAAR VETEN

Cili jam?

Kérkoj dhe kérkoj më veten time,
si më miniera tē thella.

E di, nuk jam tokë shterp, siç nuk jam dhe tokë
e florinjtë,
dhe, nëse më tepër ndër vargje mineral sot kam,
për tē zbuluar tē rrallën, duhen vite tē tjera.

Kérkoj e kérkoj çdo ditë si bujku.

Hap brazda tē thella, plehéroj, vadit,
përfytem me mëngjezet, me zhegun e netët;
mbjell, prashit, korri e përsëri rimbjell,
kérkoj çfarë toka më mirë mund tē rritë.

Duke njobur rrënjët e tokës, e djersën e popullit,
duke gërmuar thellë në qenjen time,
do të ngjitem në të përpjetën e diellit,
me çdo gjë të dashur dhe intime.

D J E P I

Nina-nana në një djep,
djep' i drunjtë me bar mali.

Nina-nana në një djep ahu,
me grushtin e babës jastëk,
legjendat e kohërave nën brinjët tona të bri-
shta.

Nën djep uji — det,
mbi djep tym e mjergull,
në djep sumbulla lotësh nga fëmij' barkthatë,
zëri i ahut në shtërgatë.

Nga nyjet e djepit çelën sytë tona,
nga rathët e djepit u hapën vitet tona,
nga shtrati i djepit u zgjatën gjymtyrët tona,
u ngritën
krisma dhe jehona.

F O R T E S A

Rri e vështroj këtë gji të vogël deti
edhe një shkëmb mes dallgëve zhytur
dhe përmbi shkëmb një fortës' të madhe,
në kujtim të viteve ngritur.

Fortesa, porsi zog vigan i mbledhur,
me gjoks nga shqota e detit kthyer,
vështrimin thellësive e ka hedhur,
nga vijnë tallazet e kthehen prap' të thyera.

Si karakolle muret e fortësës
dhe mes të çarash ndonjë tufë bar,
muret e brejtura prej kripës dhe erës,
për çdo armik — varr.

Ç'vështron ashtu fortесё e vjetér,
e ç'bisedon me kohën gjatë natës?
Të ngjan se sheh burrat himariotë
të dorëzojnë xhelepin majë shpatës?

Rri e vështroj detin, shfletoj kaltërsinë,
mendoj si mes tallazesh dhe më lart u ngrite.
Pak çaste ashtu shfletova historinë
dhe mbetën vargjet mbi fortësen epike.

NGA VETJA

Erdhi dimri,
por vajza më kërkon një fustan për pran--
verën,
ku të jetë qëndisur dielli.

Erdhi dimri,
por djali më kërkon këpucë të lehta,
të vrapijë si era.

Erdhi dimri
dhe unë kërkoj nga vetja gjithmonë,
fëmijve t'u bie pranvera të tjera.

E PAHARRUAR

Atë ditë, kur mëllenjat zbrisnin drejt fushave
dhe dallandyshet udhëtonin buzë deteve,
nën miliona flamuj të kuq të vjeshtës,
zbrita në Tiranë.

U çudita me bulevardet e gjëra,
para monumenteve qëndrova i habitur,
dhe kur opingat s'mund t'i tërhiqja më,
u ngjita në rrugën e Dibrës.

Mbaj mend si më priti kapter Nokja,
si u ndrojta nga kapter Nokja,
si më dha uniformën kapter Nokja
dhe më zbuti pak (se isha si dhi e egër),
si më rregulloi bustinën, kapter Nokja
kështu duhet nderuar, më tha kapter Nokja.

Dhe dolëm.

Mbi spaletat e mia, sikur fluturonin pullumba të bardhë.

Dhe unë duhej të nderoja dhe nuk dija kë të nderoja përpara.

Lapidarët, monumentet, si duheshin nderuar?

Flamujt e vjeshtës a duheshin nderuar?

Nxitova në rrugët e Tiranës, nxitova të gëlltisja çdo gjë të bukur.

Këpucët e rënda dhe asfalti më lodhën më tepër se të gjitha malet.

Me dorën ngritur i nderova të tërë: Njerëzit, monumentet, rrugët, flamujt.

Nxitova të nderoja gjithshka që lëvizte, se mund të më iknin si një tufë qengjash në agim.

I nderova të tërë dhe mund ta gdhija duke nderuar gjithshka të bukur, të mirë. . .

G J A K U Y N E

«Tufa-tufa, maxa-maxa...»

— Për kë i keni tufat e trëndafilave,

që ngjajnë se vijnë majë dallgëve,

drejt brigjeve, drejt fshatrave të gjelbërtë.

Dhurata juaj e çmueshme për vendin stërgjy-
shor,

trëndafilat?

Ata ikën. Po vinin osmanët t'u kthenin besën,
Himara rebele do niste nizamët.

Do duhej të kthenin emrat e fëmijëve, të ven-
deve,

ndaj ikën pa patur kohë të faleshin me ullinjtë
e pragjet.

Ikën pa parë shtëpinë e tyre, që e dogji turku,
pa parë gjyshërit e baballarët që s'pranuan të
vdisnin në dhe të huaj;
ikën në malet e Abrucos,
(për 'ta kudo pati male)
dhe mbrëmjeve në katundin e varfër Vila Ba-
deza¹)
me sy nga deti rrëth zjarresh, kënduan përmall-
shëm:
«O e bukura More!»

Ikën.
Nuk e panë më qiellin e jugut,
molin e vjetër e lanë shkretë.
Në kopshte u thanë pemët e këngët,
ndërsa eshtrat e baballarëve u treten në Bursë,
Konia² e gjetkë.

Dhe lindët në malet e Kalabrisë,
(aty ku stërgjyshërit u aklimatizuan lehtë)
pa e njohur truallin e lashtë,
duke pasur të përbashkët zemrat, detin, mallin,
tufa trëndafilash dërgoni pér vendin lavdiplotë.
O, gjaku tërheq gjakun, o kalabrezë, o pikeriotë!

1) Vala e fundit e shqiptarëve të ikur ishte nga katundi Pijeras në vitin 1774. Ata u vendosën në katundin Vila Badesa në Kalabri.

2) Bursë, Konia — vende ku u burgosën kryengritës himariotë.

DUART E VELLAIT

Ferdha në kantierin e diellit buzë Drinit
dhe humba midis punëtorëve.

Mali gjëmonte, maqinat shkonin e vinin,
lëvizte toka nën zhurmën e motorëve.

Duart e rreshkura sikur më flisnin shumë
për turnet, difektet, netët e vështira
dhe dejet i ngjanin me një lumë,
që vrullin shton dhe valët ngre të fryra...

Të çohet lart ansamblı elektrik,
duhet përleshur me shkëmbinj, me këtë lumë,
se lulet e heroizmit vaditen me djersë...
Duart e tij më thoshnin diçka më shumë.

LIBRERIA E PËRSHPEDEZUE
SHPARKU NGA
160850

PO VINTE PRANVERA

Midis lagështirës, nën qiellin ende të vrejtur,
midis cicërimave të zogjve,
çelën përsëri kumbullat;

çelën përsëri kumbullat me lule të bardha.

Një vizion i bardhë u skalit në fushë,
ndërsa rrymat e ajrit dhe të gëzimit
nxitojnë në hapësirë.

IKJA E GJINLEKËS

Breshëri godiste muret e kullave,
ndër vesh i gjëmonte krisma e tretë;
hasmi e turku si hije e ndiqnin,
ullinjtë të varur mbi gurë i thërrisin:
«Më shpejt, Gjinlekë, më shpejt!»

Shkëmbinjtë të lagur përcillnin jehonën,
vetëtimat bënин shenja mbi kështjellë,
kandilat u fikën njëherësh.
Ç'natë e thellë!

Vur dorën në murin e lagur: Lamtumirë!
Opingat s'i lidhi, hodhi trastën e kripës,

rimbushi karajfilen¹⁾ e shkretë.

«O ullinjtë e mi!»

Ndër vesh i gjëmonte krisma e tretë.

Askush s'e priste, veç maleve

dhe hasmët, si Druzët e Sirisë²⁾ do ta ndiqnin:
gjer në atë jetë..

Gurët rrökulliseshin teposhtë me rapëllimë,

«ku vete Gjinlekë?!»

Kur humbën të thirrurat e krismat mbas mba-
lesh, zbrazi armën..

O dhe, kur do të të pjek?

Male, ulërima, dhimbje...

Nga cili shteg çave Gjinlekë?

1) Karajfile — lloj pushke.

2) Druzët e Sirisë — fis i përmendur për marrje gjaku.

NE BUFENË «MARINA»

Karriget e zëna, banaku mbushur plot,
pinë peshkatarët, pinë marinaret.
Bufaja me zhurmë, bufeja më jetë
më thirri dhe mua të pija një gotë.

Skelarët e gëzuar me gjokset plot dallgë,
me gjokset leshtorë të rrahura nga era,
sikur mbajnë në gota ujëra e qiej
dhe brigje të lara.

Peshkatarët me fytyra të nxira nga dielli
pinë dhe flasin për peshkimet e mbara,
ndërsa në këmishët e djemve marinare
shoh rrugët e tyre, të kaltra, të bardha. . .

Pinë.

Çohet shkuma në gota, si dallga në bash,
pi dhe unë midis zhurmës së gëzuar,
në bufenë më të ngrohtë, që në jetë pashë.

FËMIJNI

Kujtimi i viteve të fëmijnisë troket më shumë,
çdo ditë që unë ndjehem më i shëndetshëm, më
i gëzuar, më i begatë.

Sa herë që fantazia më rrok në pushtetin e saj,
kur shoh të ardhmen dhe ndjej thell' një lëvizje të
pathënë,
një lëvizje gjaku hapësirave plot freski,
midis ajrit dhe gëzimit të njerëzve,
kudo e kurdoherë, më troket e shtrenjta fëmijni.

Fëmijnia —
aq e largët, aq e afërt njëkohësisht.

PESHKATARES SË JONIT

Ti diell ke ndër flokët e tu,
në buzë ka çelur karafili,
në ballë edhe në sy është mbledhur
tërë bukuria e prillit.

Dhe rrjeta hedh n'Jonin e kthjellët,
ku pulëbardhat rrahim krahët,
dhe përmes netëve të thella
bëhesh dhe vetë si deti, si valët.

LAMTUMIRE USHTARI

Dua t'i marr me vete të gjitha
këto kodra të murme, që i mata aq herë,
këto gështenja të ngarkuara, që i pata orientuese,
këto boriga, këta përrrenj, ku shova etjen,
këto pisha, që masin veten me hijet rrëzuara në
borë.

S'e kam t  leht  t  ndahem prej tyre.
I v shtroj nj  nga nj  dhe s'ngopem s  pari!
N  lamtumir n time t  dhimbshme dhe plot mira-
tim,
m  duhet t  rr mbej nj  cop  diell t  kuq, sip r
pishave sip r val ve,
t  rr mbej kujtimet, q  ngrihen si pikat trigono-
metrike maj  maleve.

ATE PASDITE UNË DOLA NË ARA

Atë pasdite unë dola në ara,
kur dielli shndriste aq tepër,
Midis brazdash unë çava përpara,
pas më ndoqi kujtimi i vjetër.

Thërmohoj dheu ndër këmbët e mia,
(intimet më thonin arat plot shqetësim)
tej shkonte një tufë lopësh të larme,
duke u përcjellur nga i flakti perëndim.

Atë pasdite unë dola në ara,
kur dielli shndriste aq tepër.
Ecnin karrot ngarkuar përpara,
këngë të reja në rrugën e vjetër.

PAS MBLEDHJES, KU U PRANUA NË PARTI

P. H.

Doli. Faqet i digjnin.

Dolën ushtarët nga gjelbërimi i pyllit dhe e uruan,
hapi i tij u përplas në muzgun e vrejtur.

Kaloi radhë-radhë në gjithë pozicionet.
Puthi zërin e rojeve, zërin e patrullave,
zërin e largët të gjëmimeve nëpër erë.
Ndërresat u shkëmbyen.

Hapi i tij trokiste në konturet e strehimeve,
shtrëngonte radhazi grykat e topave,
seç u pëshpëriti me radhë djegoreve
dhe gërvishi në një mburojë të gjelbërt topi
një datë,
ndërsa erërat preknin fytyrën e tij dhe digjeshin.
Atë natë nuk erdhi të flinte...

E SHTATORIT

Patjetër ti tani ke hyrë në klasë,
me nxënësit e rinj po bën apelin,
ndërsa unë, shkëmbin gri godas
dhe duart po më therin.

Në tryezë regjistrin ti shfleton,
mos emrin tim po kërkon vallë?
Unë jam larg, po hap një pozicion
dhe të kujtoj plot mall.

Dorën shtrin mbi hartë
dhe nis spjegon reliefin, Shqipërinë...
Po ja, ty dora të mbeti lart,
atje ku unë përleshem me shkëmbinjtë

ISHIN TË RËNËT

Kur hijet e natës vrapijan
dhe dolën konturet e maleve,
nga vesa,
mbushur me nektarin e luleve dhe yjeve,
rreth pozicionit të mitralozit, shpërthyen lulë-
kuqet;
një këtu — një aty...

Ishin të rënët që u ngriten në vendroje.

TARRACAT E LUKOVÈS

Po shkoja bregut me gazin e gazetës,
kalova fshatrat e gjelbërta, ja dhe Lukova,
me tarracat e ngritura, amfiteatër i kohës,
në radhën më të lartë si spektator qëndrova.

Dhe buzë detit, shpatit përkarshi,
për shfaqje s'kishin ardhur skllavopronarët.
Po valëviteshin flamuj e shami,
me kazma dirigjonin vullnetarët.

Tarracat çohen plot këngë e zjarre,
 për brezat do të jenë podiume.
 Në malli i ka marrë, Butrinti dhe Apolloni
 krenar
 të vijnë të shohin shfaqje në këto kodra të
 murme.

Në shkallën më të lartë, pak çaste qëndrova,
po përshëndesnin vullnetarët.

Në sfond t'amfiteatrit më buzëqeshtë Lukova,
përposh tundnin belin portokallet.

LULE TË BARDHA HODHI STINA

dëshmorit Milo Makoçi

Prilli sa po hapte sytë,
portokallet sa po lidhnin kokrrat e blerta,
ullinjtë sa po çelnin lule të bardha, të arta,
ai sa po mbushte gjashtëmbëdhjetë pranverat.

U vra, duke kërkuar lirinë në malet e rrepta,
me pushkë në krah dhe fitore në duar.
Ndaj kur ra,
lule të bardha ullishtash
hodhi mbi të
stina e praruar.

NË TROTUARE TRETI

Hapat trokisnin dhe bisedonin me trotuaret.
Fytyra ime në xham të një vitrine ra
dhe mbeti,
padashur shkëmbeva një vështrim
me pasqyrimin tim.
Më ra në mendje dora jote,
që flokëve të mia rrëshqiste ngadalë... .

Unë prapë u ktheva në qytetin tënd të bardhë.
Mirëseardhe më thanë gështenjat,
mirëseardhe më thanë alpet,
mirëseardhe më thanë ujërat dhe vajza e dashur
Valbona;
zbrita në qytetin tënd të bardhë,
dhe hapi im, në trotuare treti... .

VALLJA E BUKËS

Këto anë s'e njohën grurin
s'e shijuani erën e tij,
tani copa brigjesh po zverdhin
gruri me dallgët nisi t'fëshfërij.

Vajzat, që mblozhën èndrrat me portokallet si
diej,
vajzat që mbushën kanistrat me ullinj,
me drapër grurit të zverdhur i bien,
ngrejnë lëminj.

Dhe thasët të mbushur me grurin e artë
dhe kuajt që trokojnë e trokojnë
dhe perëndimi që dridhet në portokallet e blerta,
për bukën e parë po hedhin valle.

Dhe pleqt' që kultivuan grurin e parë,
thërmojnë kokrrat me duart e rreshkura.
Lulëzoftë kurdoherë kjo farë!
Po thonë ftyrat e thekura.

KRYEFJALA E KOMBIT

Partia është porsi qelli i gjerë,
që ditë të bardha ndan si një pranverë.
Stuhinë, bubullimën dhe rrufenë,
i mban rezervë, roje për atdhenë.

Ajo është porsi ortek malor,
që radhët shton në përleshje me stuhi,
dhe buzë greminës, zjarrit, e paepur,
marksizmin e shtrëngon në gji.

Partia është burimi më i kulluar,
që rrjedh nga gjoks' i tokës me furi,
porsi fëmijtë që rrojnë me gjinë e nënës,
ne rrojmë me mendjen tënde, o Parti!

Partia është si dielli në pranverë,
që hap dyert dhe dritaret tonë,
flamur në epokë, vrulli ndër beteja,
më i shtrenjti mik dhe shok.

Partia,
kryefjalë në luftë, në fitore, në ndërtim,
kryefjala e kombit tim.

MË RRËMBENI DHE MUA

Erdha të mësoj diçka nga valët,
të ulem në barka të rrahura nga shtegëtimet,
të bisedoj me fëmijtë që s'u lodhën nga loja,
të flas me peshkatarët për peshqit dhe mezet.

Rrezet e perëndimit pushtuan detin dhe qiellin,
një tis i hollë, i tejpashëm, nga retë jargavan
rrëzua;
deti me gojën e madhe gëlltiti diellin.
O valë, o rrëze, o peshkatar, në jetën tuaj
rrëmbemëni dhe mua.

TAKSIDARI

Burri me çantë e me syza erdhi përsëri,
i ngrysur, u drejtua nga shtëpia jonë
dhe ne u mblozhëm kruspull, u frikësuam,
kur gjyshja bërtiti: «erdhi prap' ai.»

Ne e dinim se burri me çantë ishte i fortë,
më i fortë se gjithë burrat e lagjes sonë;
ai mund ta shtynte dhe shtëpinë tatëposhtë
ai mund të merrte gjithshka nga varfëria jonë.

Dhe u ul. Hapi qitapin e madh,
uli syzat dhe vështroi ashtu i egërsuar.
— Më nxirrni dhin' që keni në vathë,
mjaft ju kemi pritur, mjaft ju kemi duruar.

Ne e dinim, ai do merrte diçka,
se vetëm dinte të grindej,
se vetëm dinte të rrëmbente, me ligjet e tij,
po gjyshja bërtiti: «ç'është kjo hata,
pa ejani, afrohuni, lugati na erdhi, or bij...»

U përfol, e shau dhe çantën ja hodhi poshtë,
ngriti stolin prej pishe t'i binte...,
por grykat e armëve iu kthyen drejt
dhe gjyshja ç'të bënte?
Veç gurët e fjalëve mbi kokë i vërviti.

BUZË DETIT

Buzë detit ra një hije terr,
të fundmit shëtitor brigjet lanë.
Nga deti era ca stërkala merr
dhe pistës i shpërndan.

Dhe britmat, të qeshurat, fjalët që u thanë,
si një kallam i brishtë më dysh u thyen,
në mugëtirë përmbi det ranë,
në buçimë u kthyen.

Dhe mijëra zëra po më vijnë trazuar,
i këtij bregu sonte jam shtegëtar,
ashtu buzë detit, heshtur, duke shkuar,
nga dallgët edhe era krejt i larë.

N D A R J A

Ja posta e Sarandës vjen ngadalë,
herë del, e herë zhduket nëpër kthesa,
në rrugë me nënën kemi dalë,
kërcejt' e shiut thyhen porsi fshesa.

Ajo, e mallëngjyer më përcjell,
i dridhet zëri, ende këshillon,
mbi çadrën tonë shiu rëndë shkel.
mbi krahët tona ndarja po rëndon.

Hipa në postë, «lamtumirë biro...»
Shpejtoj të fshij xhamin e djersitur,
më vijnë në vesh: «djalo, na ndero!»
dhe mbetet prapa dora e saj e ngritur.

BARITORE

Në flokët e kërleshur kanë rrëkezat e qumështit,
në qimet e brucave u kullojnë tufanet,
çobenjtë e heshtur, çobenjtë e mirë
qengjat e parë përkëdhelin,
delet kokulura i gëzohen fushës.

Me-e-e, delet bëjnë apelin.

NJË PJESE NGA QENJA IME

Bri stolave të drunjtë,
mbi atë bar që gjelbëron si gjithë barërat në
pranverë,
në rrugicat e mësuara me pëshpëritje hapash të
ngadalshme,
nën ato degë që s'pushuan asnje çast së shkundu-
ri lule,
nën atë qiell, nën ato pisha, në atë stinë,
kaloj.

Mirëmbrëma, o muzgje të pa përsëritura.
Mirëmbrëma, o degë, që kujtoja se do t'ishit
thyer,
për të mbuluar dashuritë me lule.

Çdo gjë ka mbetur e gjelbërt.
Stolat, që s'u lodhën nga të dashuruarit, presin.

Në vend të trungut të madh, streh' e qindra të
dashuruarve
në pritje, një bredh i ri ka hapur krahët,
një pjesë të qenjes sime e lashë atje të mbahet.

NGA ORIKUMI

Trokasin dallgët me takat e qullura
në gjirin gazmor e plot jetë;
zhurmojnë rrugët nga këngët e bukura,
pashai¹⁾ i limanit ka fjetë.

As brigjet, as limoni s'e kujton
pashan' mizor me ferman,
që erdhi një viti të vonë
dhe thirri: «këtu jam sultani!»

Dhe mbajti mizorisht këtë port,
për të madhen perandori;

1) Orikumi në kohën e pushtimit turk u quajt Pasha-liman.

të ngopur me pilaf, ushtarët thirrën fort
çok jasha¹⁾), o sultani!

Çok jasha, çok jasha, çok jasha!
Për të madhin osmanlli.
Endërruan të kthehen me lavdi e para,
plot qmenduri.

Troksin dallgët me takat e qullura,
Orikumi përshtendet me retë,
zhurmojnë rrugët nga këngët e bukura,
varret e osmanllijve irinë shkretë.

1) çok jasha — rroftë (turqisht)

PERENDIM NË PYLL

Nga gjethet e vjeshtës skuq shpina e malit,
pishat dhe ahet duart mbajnë shtrënguar,
dhe kushedi se çfarë i thonë diellit,
që rrezendezur ulet i nxituar.

Frym flladi. Lëkunden barërat, ahet shkunden
reshtur
ngjan se lëviz fshehtas një ushtri
dhe ja, në kreshta sikur u ndez heshtur
një zjarr i kuq prej gjethesh ahu
në qiellin ngjyrë trëndafili.

P Y E S D E T I N

(Motiv kurbeti)

Nisën shirat vjeshtore,
përrenjtë filluan të gërryejnë faqet e maleve përsëri.

Mbi portokajt, limonat e mandarinat, mbi vargun
e gjatë të ullishtave,
rrëshqasin dyndjet e shirave.

O det! Ç'm'i bëre t'afërmit e mi?

Qëndroj duke thithur erën e detit dhe vështroj
thellië . . .

Këtej morën gjyshërit rrugën e kurbetit
dhe s'u kthyen më.

I treti gjyshërit, kurbeti, i treti . . .

Dallgët kërcejnë mbi brigjet e bardha,
në këto brigje që përcollën aq dëshira
me buçimën e tyre plot kuje;
por ata nuk i ktheu më deti,
ç'm'i treti të afërmit kurbeti, ç'm'i treti.

Ç'thotë juga që fryn si e marrë,
duke ngritur brigjeve pallate ranore.
(Si s'u kthyet, o, të uruar, për tu parë?)
Ç'i bëre të afërmit e mi, o det?
Për brigjet, për tokën, për gurët malli i ka marrë.

ATO ÇASTE

Ishim të gjithë në dritare.

Duke pritur, më kujtoheshin dritat e Vlorës
dhe më ngjante se do kredhesha në ujëra të fres-
këta.

Kur, frrap,
sikur rrezet e diellit në trup më ranë.

Mbaj mend se thirrëm: «dritë!»

Sytë më shndritën më tepër se gjithë dritat e nde-
zura,
dhe kërceva lart, lart të rrökja dritën,
vrapova jashtë, shtrëngova trungun e portokalles...
Vezullonin qiparizat, vezullonin pellgjet, vezullon-
te deti,
sikur çelën njëherësh lulet e prillit.

Pashë, në atë mbrëmje nëntori me shi,
gjithshka që shndriste,
si deti pas mjegullës nën rrezet e diellit,
dhe ndjeva atë që në ëndrrën më të bukur,
s'e kam ndjerë deri tashti.

3

DO TË VIJNË MËNGJEZET

Rëra e lagur peshkatarët përcjell,
rremat çajnë ujërat e vakura,
mbrëmja kaltërsit' e ujërave dhel
dhe mbyll horizontet e hapura.

Midis ujërash melodira kalojnë,
tok me to reflekse t'fanarëve tonë,
në ujërat e Jonit peshkatarët peshkojnë
në ujërat e kaltërta, në orët e vona.

Dhe do të vijë mëngjezi, nga ujërat e kaltërtat
rrjetat do ngrihen të mbushura plot,
do të zbresin në breg dallgët e pastërtat...
mbi ujërat e Jonit do fryjë era e ngrohtë.

MORA NGA VERIU

S'e mbaj mend, tē parën vjershë ku e shkrova
tē fundmin varg ku do ta them, s'e di.
Me gryka topash shpesh unë këndova
dhe zjarr kam hapur tok me poezi.

Horizonte blu shfletova në veri,
u bëra mik me majat në tufan
dhe duke matur ato kaltërsi
ca varge tē njoma si fjolla bore më ranë.

S'e mbaj mend ku shkrova vjershën e parë,
vargjet e fundit ku do t'i shkruaj s'e di...
Nga lugjet, grykat, majat kam marrë
vrullin e përrenjve, reflekset e borës,
në zemër dhe në sy.

KU NDEJTEM BASHKE

Duke kaluar në atë vend,
shoh dallgët të luajnë me vëtminë e tyre,
ndërsa bregu dremit...
Vështroj,
atje ku ishe ulur,
një kujtim i zgjuar rri.

P R A N V E R Ë

Ato pasdite, që uleshin mbi rrugët,
mbi bliret e lulëzuara të trotuareve,
mbi vajzat që nxitonin, mbi vitrinat e mbushura
plot gjelbërim,
plot vesë fushash e ngjyra ylberesh,
ato pasdite, që gjithmonë më janë dukur se zbris-
nin kudo të gëzuara,
mbi plepat fjalëshumë, mbi ujërat që avullonin
duke vërshuar,
mbi Taraboshin shpatullgjërë, mbi Cukalin krye-
gjelbër,
që zbrisnin të dashuruara mbi qytetin e Shkodrës
dhe majat ngjanin si vajza vetullgjëra;
nuk e di pse s'mund t'i harroj.

S'kam qenë i dashuruar,
s'kam rendur pas vajzave, atyre pasditeve
qëndroja në këmbë buzë trotuareve i dehur ngaz
mushti i luleve..

Vështroja diellin, vështroja njerëzit,
vështroja rrugët që spërkateshin nga uji, lulet
e blireve dhe akacjeve,
vështroja si zbriste nga oxhaqet, mbi njerëzit, mbi
ujërat,
e dashura, pranvera ime dhe e qytetit.

MES JUSH MË SOLLI KËNGA E VJETER

Pranvera e 42-shit ju përçolli e trembur,
larg, përtej, në brigjet e Brindisit, Palermos në
Siçili.

Ju përçolli në ishujt e zhveshur,
se deshët pranverë dhe liri.

Në Ustica gjetët shokë me ngjyrën e gurëve,
qeli të zymta që kafshuan jetën tuaj;
gjetët apelin e gjatë në mes të diellit dhe urissë,
dhe asnje pikë ujë në atë ishull të huaj.

Ju kafshuan gurët çdo ditë,
dhe valët e kripura plagët jua gërryen,

ju ndëshkuan pranverën dhe të ritë,
por agimet e bardha dot nuk i thyen.

Mbi eshtrat tuaja, që ranë në çdo metër
dielli kaloi dhe bari u rrit...

Më solli mes jush kënga e vjetër,
pranvera e zemrave tuaja na mbërriti.

EURIDIKES

Vajzës sime

Dikur këndeje banoi fisi euritan,
që Tukididi tha se gjuha e tyre që e panjohur,
me dyndjen e kohërave të gjitha vanë,
Epiri dhe Etolia mbetën rrënuar.

Anfilokët, Kaonët, Tesprotët, Molosët
koha barbare i preu me thikë
dhe ja mbas shekujsh që humbën kolosët,
në viset e tyre lindi çupa Euridikë.

Me gjuhën e tyre diçka dua t'i them,
por ajo tund doçkat, asgjë nuk kupton;
nuk i flas për statuja, Butrintin e Orfenë,
i flas për vendlindjen që kundërmon limon.

I them për Euritanët, fisin tonë të parë
dhe portokajt na varen si hënëza pas resh,
ajo thith erë limoni në këtë breg të larë
dhe buzëqesh.

Ajo qesh me fjalët e fisit tonë të pakuptuar,
që helenët i quajtën barbarë dhe i patën frikë.
Në këto vise të lashta, kohërat, petale kanë lu-
lëzuar
dhe petale po shkundin mbi çupën Euridikë.

MOTIV I LASHTË

*«Çomëni krua më krua të la-
hen vashat tek mua*

1

Drurët ishin zhveshur. Frynte juga.
Gjoni¹⁾ qante përmallshëm vrasjen e vëllait,
gurët lëshoheshin poshtë në përrua,
era ndukte faqet e sukave.

2

Plaga jote ishte hapur tepër
dhe gjaku rridhete lumë,

1) Gjoni — Zog që sipas legjendës qan vëllain e vrarë.

unaza e hënës në thupra,
kurora mbi kurm.

3

Ngrite sytë nga qielli, kur qent e fundit lehnin
(deshin të pinin gjakun tënd të mpiksur),
hëna pikonte gjak mbi piramida shkëmbinjsh
karpa e malit e krisur.

4

Qiell' i vrejtur e dhimbje.
Ra dhe muzgu, asnë nuk kaloi afër,
asnë nuk dëgjoi dhimbjen dhe amanetin tënd;
atëhere nisi shiu...
me lamë kryet në atë ujë të rëndë.

PAS SHTËRGATËS

Kushedi se ku u arratis shtërgata
dhe mbeti pylli si fushë e lënë beteje.
Këtë mëngjez të qullur na la prapa,
s'di ç'vizaton mbi ne bishti i një reje.

Nis e lëviz gjithshka: trungjet kërcasin,
kërpudhat si ovale hapin sytë,
shpërndan agimi hijet mjegullore.
Trokasin qukapikët,
çohet një botë e tërë, që në shtërgatë
i pati rënë të fikët.

Rrezet vrapijnë —
agim.

K T H I M I

U kthëva dhe përmes fshatrave po hyj;
guriçkat duket po ma bëjnë me sy.

Shtëpitë sikur më thonë: njatjeta oficer,
dhe juga kapën flur ma merr.

Dhe ai prag, ku trimi një ditë ra,
një lapidar të madh mban në krah.

Këpus një degë, përulem përmbi ju
dhe ngrihem i përlotur grushtin lart, kështë

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Kur takoj Enverin	3
Shqetësim	4
Ishin këngët	6
Duke kërkuar veten	7
Djepi	9
Fortesa	10
Nga vetja	12
E paharruar	13
Gjaku ynë	15
Duart e vëllait	17
Po vinte pranvera	18
Ikja e Gjinlekës	19
Në bufenë «Marina»	21
Fëmijni	23
Peshkatares së Jonit	24
Lamtumirë ushtari	25
Atë pasdite unë dola në ara	26
Pas mbledhjes ku u pranua në parti	27
E shtatorit	28
Ishin të rënët	29
Tarracat e Lukovës	30
Lule të bardha hodhi stina	32
Në trotuare treti	33
Vallja e bukës	34

	Faqe
Kryefjala e kombit	36
Më rrëmbeni dhe mua	38
Taksidari	39
Buzë detit	41
Ndarja	42
Baritore	43
Një pjesë nga qenja ime	44
Nga Orikumi	46
Perëndim në pyll	48
Pyes detin	49
Ato çaste	51
Do vijnë mëngjezet	53
Mora nga veriu	54
Ku ndenjëm bashkë	55
Pranverë	56
Mes jush më solli kënga e vjetër	58
Euridikës	60
Motiv i lashtë	62
Pas shtërgatës	64
Kthimi	65

Redaktor: Pandeli Koçi

Kopertina nga Sofokli Koçi



Tirazhi 1.500 kopje Format 70 x 100/32 Stash: 2204 - 72

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike
Shtypshkronja «8 NËNTORI» — Tiranë, 1973